



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

TESTI GJUHË SHQIPE

Viti shkollor 2015/2016

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати без претходне сагласности Завода за редновање квалитета образовања и васпитања.

1. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

Para vëllezërve Lymier, babai i Motion Picture apo fotografisë në lëvizje ishte Louis Le Prince, i cili me vitin 1888 e xhiroj një film te metrazhit të shkurtër 2 sekonda. Me një kamerë me 12 framë në sekondë i titulluar Roundhay Garden Scene. Shfaqja e parë filmike u bë në vitin 1895, nga vëllezërit franceze Lymier. Ishte njëra nga shpikjet me të mëdha të shekullit, por filmit të asaj kohe i mungonte zëri. U deshën shumë vite eksperimente derisa në vitin 1926, vëllezërit Verner njoftuan lindjen e filmit të parë me zë. Ky film ishte Don Zhuani. Në Paris ky film u dha nëpër kinema për rreth një vit dhe solli rreth 8.5 milion franga të ardhura. Filmi Don Zhuani ishte i regjistruar me sistemin e zërit vitafon (ky sistem e regjistronte zërin në pllaka gramafoni në rrugë elektromekanike). Në vitin 1927 kompania filmike Fox Movies hodhi në treg një sistem të ri regjistrimi të quajtur Movieton. Me këtë sistem, regjisori i mirënjohur francez Rene Cler bëri filmat e parë të mirëfillte me zë. Këto filma ishin: "Nën pullazet e Parisit", "Milion dhe Liria na përket neve" dhe "4 korrik". Revolucioni audio fonik ishte shpikja e shiritit ferro magnetik, magnetofonit dhe shpikja e audios stereo. Por u deshën 90 vjet që kinemaja të arrinte nivelin e sotëm.

Teksti i mësipërm është shkruar në:

- a) stilin gazetaresk
- b) stilin shkencor
- c) stilin bisedimor
- d) në stilin letrar

2. Dokumentet e para të shqipes së shkruar

Dokumentet e para të shqipes së shkruar janë:

1. Formula e Pagëzimit (1462);
2. Fjalori i Arnold Fon Harfit (1497) dhe
3. Perikopeja e Ungjillit të Pashkës (fundi i sh. XV-fillimi sh. XVI).

Nën pluhurin e arkivave të Evropës dhe sidomos të atyre të Vatikanit mund të gjenden edhe shumë dokumente të tjera, ndoshta më të plotë e më domethënës.

Lexo tekstin e dhënë dhe duke shkruar në viza përgjigjen trego:

1. Cili është titulli i këtij shkrimi?

2. Cili është dokumenti i parë i shqipes së shkruar?

3. Ku mund të gjenden edhe shumë dokumente të tjera?

3.

Gdhendësit

Koni u mbështet te trunq i pemës dhe fi lloi të qeshte me të madhe.

- Si mund të bësh një zbukurim për prijësin tonë me atë sëpatë të plogët,- e pyeti Abunë përmes të qeshurave. – Harrove kur shkuam në oborrin e tij për të dëgjuar rregullat e mbretërisë?

Harrove që piramida e tij është një nga vendet më të bukura të mbretërisë? Prite këtë trunq në dy pjesë. Pastaj me copën time të drurit, unë do të gdhend një zbukurim për Hunakun.

Abuja e pa vëngër dhe me mosbesim. Me një goditje të vetme ai e ndau trunqun në dy pjesë dhe e hodhi njërën prej tyre te këmbët e Konit.

- A do të mundesh vërtetë që me thikën tënde të vogël të gdhendësh diçka të bukur për prijësin tonë?- e pyeti Abuja me një zë të mbushur plot mllef. - Ti s'ke për ta mbaruar kurrë atë punë.

Ditët që pasuan të dy druvarët vazhduan punën e tyre, por gjatë kohës së drekës, secili tyre shkante në vendin ku kishte fshehur copën e vet të drurit. Pastaj, në mënyrë të fshehtë, gdhendnin pa pushim.

Më në fund erdhi dita, kur secili gdhendës e pakatoi punimin e vet dhe mori rrugën për në oborrin mbretëror, i cili gjendej rreth gjysmë dite larg.

Në një shteg të pyllit, Abuja dhe Koni u takuan me njëri-tjetrin.

- I shkreti Abu! – bërtiti Koni, duke i hedhur një vështrim të shpejtë pakos që mbante në dorë tjetri. - Prijësi ynë nuk do ta pëlqejë punën tënde, pasi ti kurrë nuk ke mundur të gdhendësh diçka të bukur me atë sëpatë.

- Ty duhet të të vijë keq Kon, - iu përgjigj i qetë Abuja. – Prijësi ynë nuk do ta pëlqejë veprën tënde, sepse nuk ka dyshim që ajo do të ketë shumë gërvishtje dhe të çara të shkaktuara nga thika jote.

Lexo pjesën e dhënë dhe trego pse Abuja mendon se Koni do të dështojë? Qarko përgjigjen e saktë.

- a) Hunaku nuk e pëlqen Konin.
- b) Koni nuk është i njohur si një gdhendës i mirë.
- c) Koni nuk ka shumë kohë të lirë për të punuar.
- d) Thika e Konit është shumë e vogël.

4.

Në tekstin e shkruar më poshtë dallo se në cilin paragraf janë përdorur rregullat drejtshkrimore të gjuhës.

Alberti po gutet me mrrri në punë. Treni duhet me u nis në orën xhasht e 45 minuta. Atij i duhen edhe 10 minuta me mrrri deri n stacion. Ora osht 6 e katërdhet minuta. A do ta mrrrije me koh trenin Alberti?

Në rrugë ndaloi një veturë, ishte Ariani shoku i tij i punës, e ftoi që të hipte në veturë dhe të shkonin bashkë në punë. Ariani e pyeti: - po përse me kaq nxitim o Albert? Si duket të paska zënë gjumi pak më shumë sot. Ai nuk foli, por vetëm pohoi me kokë.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së sakt.

- a) paragrafi i dytë
- b) paragrafi i parë

5. Lexo fjalitë e dhëna dhe dallo cilat fjalë nuk janë shkruar drejt sipas rregullave drejtëshkrimore. Në vizat përkatëse shkruaji ato.

a) Aktyvitet jashtëshkollor. _____.

b) Punojka akoma. _____.

c) Ambijent i pastër. _____.

d) Shkëmbyemje përvoje. _____.

6. Lum e lum për t'lumin Zot,
Nu'jem kanë e Zoti na ka dhanë!
Kurr ish'kanë Muja djalë i ri,
M'a kish cue baba n'rroge tu njizotni;
Çoban lopesh zotnija e ka ba,
Për gjith ditë bjeshket Muja tu'i kerkue;
Për gjith ditë nder gurra t'u u freskue,
Për gjith ditë nder mriza tuj pushue
Rruge as shtek pa njoftë nuk ka lane.

-Tekstin e mësipërm, në vizat e dhëna, shkruaje n; gjuhën letrare, standarde.

7. Në fjalitë e shkruara më poshtë janë përdorur pjesë të ligjëratës gjegjësisht klasa të fjalëve të ndryshueshme dhe të pa ndryshueshme. Trego se cilës pjesë të ligjëratës i takonë secila nga fjalët e nënvizuara:

Nesër do të nisem për Paris.

Ajo mbaroi shkollën me rezultate të mira.

1) _____

2) _____

8. Shpjegoni si janë formuar këta emra?

Çlirim

Përdor

I paaftë

a) parashtesa + rrënja

b) prapashtesa + rrënja

c) prapashtesa + parashtesa

Qarko shkronjën para përgjigjes së saktë.

9. Emrat e poshtëshënuar caktoni cilit grup të emrave i takojnë?

Gëzim

Karrige

Shtëpi

Dashuri

Dorë

Ëndërr

Hidhërim

Veturë

a) emrat konkret _____

b) emrat abstrakt _____

10. Foljet e dhëna radhiti(shkruaj në vijën përballë mënyrave), sipas mënyrave që i përkasin.

larë, hapur, lënë, lexuar, duke mësuar, duke hyrë, duke ngrënë, për të fjetur, për të kënduar, për të fshirë, gjeni se në cilat forma të pashtjelluara janë:

a) përcjellore _____

b) paskajore _____

c) pjesore _____

11. Në fjalinë e dhënë trego se prej sa pjesëve është formuar ajo dhe me se janë bashkuar ato?

Treni po i afrohej qytetit të Preshevës, që gjendet në jug të Sërbisë.

a) përbëhet prej _____

b) Ato janë bashkuar _____

12. Formoni fjalë të përbëra duke bashkuar me vizë fjalë nga grupi A me fjalë të grupit B

Grupi A

Faqe

Ditë

Zemër

Gjel

Shumë

Mjekër

Grupi B

bardhë

deti

gur

kuq

lindje

njgjyrësh

13. Në fjalinë e dhënë nënvizo fjalën ku bie theksi.

Shigjeta, për habi, nuk e goditi prenë.

14. Gjeni se në cilën mënyrë janë përdorur foljet në këto fjali?

U bëfsh njëqind vjeç!

Rrofsh sa malet!

Të priftë e mbara!

a) mënyra urdhërore

b) mënyra habitore

c) mënyra dëshirore

Rretho shkronjln para përgjigjes së saktë.

15. Romani “Fantazma dhe plani 3+4” i autorit Petro Marko është roman:

- a) artistik
- b) fantastiko – shkencor
- c) historik

Rretho alternativën e saktë.

16. Cili nga poetët e mëposhtëm i ka shkruar këto vargje:

Më ndjekin topi dhe zogjtë,
Oh, kush s’më ndiqka.
Qenka e vështirë, mjaft e vështirë, o miq,
T’u largoje nga fëmijëria.

- a) Ervin Hatibi
- b) Ali Podrimja
- c) Fatos Arapi
- d) Zhak Prever

17. Ngjarjet në romanin “Kronikë në gur” ndodhin:

- a) në të tashmen;
- b) në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare;
- c) në të ardhmen.

Qarko përgjigjen e saktë.

18. Herakliu ishte princ mbretëror dhe nip i heroit Perse. I ati i tij mori për të shumë mësues të ditur, të cilët veç gramatikës, i mësuan gjithë dijet dhe artet e kohës. Ata e përgatitën për rrugën e lavdishme që e priste... Ende djalë, Herakliu, dallohej për shtatin e madh dhe forcën e rrallë. Shumë herë ai nuk e përmbante dot veten kur inatosej. Në një shpërthim të tillë zemërimi, goditi mësuesin e poezisë, Enonë. Heroi kishte shkruar disa vargje, por ishte treguar ca i guximshëm në mendime. Kur ia tregoi mësuesit, ai i quajti të pahijshme dhe qeshi me tallje. Herakliu nuk u përmbajt dhe u soll keq. Pastaj qau, u pendua, por ishte vonë.

Lexo fragmentin nga vepra “Prometeu i lidhur“ dhe trego gjininë letrare së cilës i takon:

- a) dramë
- b) tragjedi
- c) komedi

Qarko përgjigjen e saktë.

19. Përcakto figurat letrare:

- a) me një milion befasira _____
- b) i kaltër si një rrobë mëndafshi _____
- c) plaku të bekuar _____
- d) me qiellin rroket, me diellin puthet _____
- e) turinjtë e makinës _____

20. Lexo këto vargje dhe trego se figura letrare që i përshkon ato:

Porsi kanga e zogut t'verës,
qi vallzon n'blerim të prillit;
porsi i ambli fladi i erës,
qi lmon gjit e drandofillit;
porsi vala e bregut t'detit,
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,
porsi ushtima e një tërmetit,
ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.

a) metaforë;

b) antitezë;

c) krahasim;

ç) epitet.

Rretho përgjigjen e saktë.



Rezultati në testin nga gjuha shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!

Rezultati në nivel të detyrës

Rezultati i përgjithshëm në test
(prej 0 deri 20)

		,	
--	--	---	--

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pikët	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

1. _____

2. _____

3. _____

Kontrolluesi:

4. _____

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	